



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 14/1 Prot.

Tiranë, më 15.06.2020

Njoftim për bashkëpunëtorë

Në kuadër të programit “Përmirësimi i praktikave gjithëpërfshirëse në parashkollor, nxitja e sjelljeve pozitive për reduktimin e dhunës dhe inkurajimi i veprimeve të inicuar nga fëmijët për mbrojtjen e mjedisit dhe reduktimin e rreziqeve natyrore”, të mbështetur nga UNICEF, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) kërkon bashkëpunëtorë të jashtëm.

Bashkëpunëtorët duhet të plotësojnë këto kërkesa:

1. Të kenë mbaruar arsimin e lartë.
2. Të kenë përvojë paraprake në hartimin e dokumenteve kurrikularë, përgatitjen e materialeve mbështetës për mësuesit, zhvillimin e trajnimeve, monitorimin e veprimtarive në klasë dhe në shkollë etj., në arsimin parashkollor dhe në arsimin bazë.
3. Të kenë marrë pjesë në projekte dhe veprimtari që lidhen me zhvillimin profesional të mësuesve në arsimin parashkollor dhe në arsimin bazë.
4. Të kenë aftësi bashkëpunuese dhe aftësi të punës në grup.
5. Preferohen përfshirjet afatgjata në fushat e mësipërme të veprimtarive.
6. Preferohet zotërimi i gjuhës angleze.

Kandidatët duhet të dorëzojnë CV-në dhe këto dokumente (fotokopje e diplomës së shkollës së lartë, kopje të dokumentit të identitetit) pranë sekretarisë së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, brenda datës 26.06.2020, ora 16.30.

Faleminderit!